


Të përgjigjeshmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr ____ prot.

Tiranë, më ____ 2019

Lënda:

Propozim për projektligj

Drejtuar :

Z. Gramoz Ruçi

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

K Ë T U

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend nismën ligjore: projektligj “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”.

Bashkëlidhur, projektligji dhe relacioni shoqërues.

Me respekt,

1. Ergjenti
 2. Anastas
 3. Adnan Shumati
 4. Ilir Lallaj
 5. Elina Xhina
 6. Andrea Mato
 7. Vidua Bello
 8. Benir Boari
- Gjenerali*
Angjeli
Shumati
Lallaj
Xhina
Mato
Bello
Boari

9. Seniola Chen *Seniola*

10. Equis Lushui *Equis*

11. Blechno Gytanet *Blechno*

12. Kestole Bushue *Kestole*

13. Elong Gulup *Elong*

M, Fete Velsy *Fete*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. __, datë _____

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kuadrit ligjor për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, në vijim Akademia.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji janë, Akademia, organet e saj përbërëse dhe ato që veprojnë pranë saj, si dhe marrëdhëniet e Akademisë me institucionet e tjera të kërkimit shkencor dhe të politikave të zhvillimit të tij.

Neni 3

Akademia

1. Akademia është institucioni publik më i lartë që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish.
2. Akademia është institucion autonom në fushën e kërkimit, që e mbështet veprimtarinë e saj në prova shkencore dhe në dobi të vendit.
3. Akademia, si person juridik, është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, që në këtë ligj do të quhet Asamble.
4. Selia e Akademisë është në Tiranë. Ajo ka logon dhe simbolet e saj zyrtare.

Neni 4

Përbërja e Akademisë

1. Akademia si institucion përfshin organet e saj drejtuese:
 - a) Asambleja;
 - b) Kryetari;
 - c) Kryesia.
2. Akademia përfshin edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë saj, si:
 - a) Seksione;
 - b) Komisione;
 - c) Njësi të kërkim-studimit;
 - d) Akademia e të Rinjve;
 - e) Biblioteka;
 - f) Enti botues;
 - g) Administrata ndihmëse.

Neni 5

Roli dhe funksionet kryesore të Akademisë

1. Të pranojë si anëtarë në radhët e saj dijetarë, krijues e kërkues të shquar në fushën e shkencës dhe të kulturës, të cilët përmbushin standarde të larta në lidhje me personalitetin, punën dhe reputacionin në shkencë e kulturë.
2. Të kontribuojë e të promovojë arritjet e kërkimit shkencor dhe të propozojë fusha të reja kërkimore e studimore në përputhje me përparësitë e nevojat e zhvillimit të vendit.
3. Të organizojë konkurse kombëtare e ndërkombëtare e të japë çmime, me qëllim promovimin e shkencës dhe të kërkimit shkencor.
4. Të këshillojë e të ndihmojë me rekomandime, ekspertiza e opionenca qeverinë dhe institucionet qendrore për aspekte të rëndësishme të kërkimit shkencor, të formimit të specialistëve të lartë dhe të planifikimit të projekteve të së ardhmes.
5. Të kontribuojë në përgatitjen e promovimin e shkencëtarëve të rinj.

6. Të nxisë dhe të udhëheqë krijimin e njësisë të veçanta të kërkimit, si dhe të hartimit të strategjive të zhvillimit të shkencës e të kërkimit shkencor.
7. Të botojë organe periodike dhe vepra të tjera me nivel të lartë ndikimi shkencor.
8. Të bashkëpunojë me institucionet e vendit me kapacitet kërkimi, si institucionet e arsimit të lartë, institutet dhe qendrat e kërkimit, me qëllim koordinimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e kërkuesve të rinj.
9. Të bashkëpunojë me institucionet analoge jashtë vendit për promovimin e arritjeve dhe për tërheqjen e projekteve të përbashkëta, për diplomacinë shkencore dhe për të përfaqësuar në shkallë ndërkombëtare komunitetin shkencor shqiptar.
10. Të organizojë kongrese, konferenca e simpoziume shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare. Të mbështesë metodologjitë bashkëkohore për shkencat shoqërore që kanë për objekt historinë kombëtare, identitetin shqiptar dhe njësinë e gjuhës shqipe.
11. Të ruajë, të dokumentojë dhe të përcjellë trashëgiminë akademike, përmes botimeve përmbledhëse të veprave të figurave më të spikatura, zhvillimit të aktiviteteve, ekspozitave dhe muzeve të ngritura në përputhje me legjislacionit përkatës.
12. Të propozojë metoda e kriteret për matjen dhe vlerësimin objektiv të cilësisë dhe kontributeve në procesin e kërkimit shkencor.
13. Të orientojë fushat dhe nënfushat prioritare, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shkencën, për kërkimet shkencore të doktoratës; të analizojë arritjet dhe problematikat e këtyre kërkimeve dhe të hartojë në çdo dy vjet një raport publik për to.
14. Të inkurajojë si prioritet të kërkimit akademik interdisiplinaritetin dhe të mbrojë deontologjinë e tij.
15. Të monitorojë procesin kërkimor që realizohet në rrjetin e institucioneve publike e jopublike dhe të botojë rezultatet e këtij monitorimi.

KREU II

PËRBËRJA E DETYRAT E ASAMBLESË

Neni 6

Asambleja

1. Asambleja është trupa e shkencëtarëve dhe e kërkuesve, dhe përbëhet nga akademikët dhe akademikët e asociuar, që do të quhen anëtarë të Asamblesë. Numri i akademikëve është deri në 30, ndërsa numri i akademikëve të asociuar është deri në 10.
2. Anëtarët zgjidhen nga Asambleja ndër mbajtësit e titullit "Profesor", që kanë një kontribut të veçantë me një ndikim të gjithëpranuar në fushën përkatëse, në bazë të kandidaturave të përzgjedhura nëpërmjet procedurave e kriterëve të përcaktuara në statutin e Akademisë. Në procedurat e kandidimit e të përzgjedhjes përfshihen edhe struktura a përfaqësues të institucioneve të kërkimit shkencor, të arsimit të lartë e të kulturës. Në procedurat e kandidimit dhe të zgjedhjes mbahen parasysh, kuotat gjinore në bazë të specifikave të procesit. Në raste të veçanta, anëtarë zgjidhen personalitete me kontribut të spikatur me jehonë kombëtare e më gjerë nga fusha e krijimtarisë artistike, kulturës

- dhe jetës sociale në përgjithësi. Si rregull, akademikët zgjidhen nga radhët e akademikëve të asociuar. Në rast kandidimi të drejtpërdrejtë kërkohet votimi me 2/3 i Asamblesë. Asambleja zgjedh edhe anëtarë të jashtëm ndër personat me shtetësi apo origjinë shqiptare me banim jashtë vendit, figura të shkencës e të kulturës, si dhe anëtarë nderi ndër figurat e shkencës e të kulturës që janë shtetas joshqiptarë me banim jashtë vendit, të cilët me punimet e tyre kanë ndikuar në ecurinë e mendimit e të zbatimit të shkencës në Shqipëri apo në promovimin e të vërtetave dhe të vlerave të origjinës, gjuhës e kulturës shqiptare. Numri i anëtarëve të jashtëm është deri në 10, ai i anëtarëve të nderit deri në 15. Personat me origjinë shqiptare që janë anëtarë me të drejta të plota të një akademie pjesëtare të "All European Academies", fitojnë drejtpërdrejt statusin e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave, e cila formalizohet nga një mbledhje ceremoniale të Asamblesë. Këta të fundit nuk përfshihen në llogaritjen e kufirit maksimal të sipërcituar.
5. Anëtarët e Asamblesë që mbushin moshën 75 vjeç, marrin statusin e anëtarit "Emeritus". Ata nuk përfshihen në llogaritjen e kufizimeve të pikës 1 të këtij neni.
 4. Personat e zgjedhur sipas këtij neni, quhen "Anëtarë të Akademisë".

Neni 7

Detyrat e Asamblesë

Asambleja kryen detyrat si vijon:

1. Zgjedh anëtarët e Akademisë.
2. Zgjedh Kryesinë (Kryetarin, nënkryetarin, sekretarin, drejtuesit e seksioneve).
3. Miraton projektbuxhetin vjetor.
4. Miraton raportin e punës së Akademisë për vitin përmbyllës.
5. Miraton programin e punës për vitin pasardhës, si edhe programet afatgjata e strategjitet e zhvillimit.
6. Miraton Statutin e ndryshimet në të me 2/3 e votave.
7. Miraton apo ratifikon projektligjin për shtesa e ndryshime në ligjin për Akademinë e Shkencave, si dhe marrëveshjet që nënshkruan Akademia me të tretët, sipas përcaktimeve në Statut.
8. Përcakton llojet e çmimeve e kriteret e dhënies së tyre.
9. Përcakton prioritetet afatmesme dhe afatgjata të Akademisë.
10. Miraton apo ratifikon aderimin e Akademisë në organizata a bashkime ndërkombëtare të natyrës shkencore.
11. Asambleja kryen edhe çdo detyrë të ngarkuar me Statut.

Neni 8

Mbledhjet e Asamblesë

1. Asambleja mbledhet si rregull dy herë në vit.

2. Zgjedhjet për anëtarët e rinj të Kryesisë zhvillohen gjithnjë në fund të vitit, përveç rasteve të mbetjes së vendeve të lira në organet drejtuese, sipas përcaktimeve në Statut.
3. Asambleja çdo vit zhvillon një mbledhje të zgjeruar të saj për miratimin e projektbuxhetit, programit dhe raportit vjetor.
4. Mbledhjet quhen të rregullta kur në to merr pjesë mbi 1/2 e anëtarëve të Asamblesë.
5. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë, me praninë e mbi 1/2 e anëtarëve, përveç rasteve të parashikuara në këtë ligj e në Statut.
6. Zgjedhjet për personat që ushtrojnë kompetencat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 7 të këtij ligji, bëhen me votim të fshehtë dhe me shumicë absolute të të gjithë anëtarëve.
7. Mospjesëmarrja e anëtarëve emeritus nuk cenon arritjen e kuorumit apo në përcaktimin e shumicave të cilësuar.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Asamblesë

1. Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet drejtuese dhe në strukturat në përbërje ose pranë Akademisë.
2. Të marrin pjesë aktive në mbledhjet e Asamblesë, të seksioneve dhe të komisioneve.
3. Të luajnë rol aktiv në stimulimin dhe promovimin e shkencës e të kërkimit shkencor në institucionet ku punojnë apo në fushën përkatëse.
4. Të zbatojnë detyrat e marra nga Asambleja, Kryesia, Kryetari, kryetarët e seksioneve apo komisioni përkatës.
5. Të marrin pjesë aktive në kongreset, konferencat e veprimtaritë zyrtare të Akademisë dhe të organeve të saj.
6. Të kërkojnë dhe të marrin informacion për punën shkencore, planet dhe programet e përgatitura nga institucionet e arsimit të lartë dhe nga institucionet kërkimore për fushën që mbulojnë.
7. Të japin ekspertizë dhe këshillime për institucionet shtetërore e ato publike të shkencës dhe të arsimit.
8. Të marrin pjesë në senatet akademike dhe komisionet e përhershme të institucioneve publike të arsimit të lartë apo në institute ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre, apo kanë ushtruar për një kohë të gjatë në një prej tyre si anëtarë *ex officio*.
9. Të marrin pjesë në njësitë apo grupet e punës për studimin, hartimin dhe kërkimin në fusha të caktuara.
10. Të përfaqësojnë Akademinë e Shkencave në komisione, borde dhe këshilla ekspertize me karakter ndërinstitutional.
11. Anëtarët emeritus lirohen nga detyrimet e pikës së dytë dhe nga e drejta për t'u zgjedhur në organet drejtuese.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të tjerë

Anëtarët e jashtëm dhe ata të nderit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë dhe në gjithë aktivitetet e Akademisë. Me pëlqimin e tyre, ata aktivizohen dhe kontribuojnë në plotësimin e detyrave të Akademisë dhe të anëtarëve të saj të parashikuara në nenet 5 dhe 9 të këtij ligji.

KREU III

ORGANET EKZEKUTIVE

Neni 11

Kryesia

1. Kryesia është organ ekzekutiv i Akademisë.
2. Kryesia përbëhet nga Kryetari, nënkryetari, sekretari dhe drejtuesit e seksioneve.
3. Kryesia zgjidhet nga radhët e Asamblesë çdo 4 vjet, përveç sekretarit të Akademisë që zgjidhet çdo 5 vjet; të gjithë me të drejtë rizgjedhjeje deri në dy mandate.

Neni 12

Detyrat dhe kompetencat e Kryesisë

1. Detyrat dhe kompetencat e Kryesisë janë:
 - a) organizon dhe drejton Akademinë në bazë e në zbatim të ligjit, statutit e vendimeve të Asamblesë;
 - b) ndjek dhe organizon punën e seksioneve, komisioneve, si dhe të njësive të ngritura pranë Akademisë;
 - c) organizon dhe drejton punën e administratës së Akademisë, përfshirë edhe entin botues, në bazë të "Rregullores së brendshme";
 - d) përgatit projektprogramin e projektbuxhetin;
 - e) përgatit mbledhjet e Asamblesë;
 - f) përgatit raportin vjetor.
2. Për kryerjen e detyrave të saj Kryesia nxjerr vendime të brendshme. Vendimet e brendshme merren me shumicë të thjeshtë. Në rast barazimi, është përcaktuese vota e Kryetarit. Kryesia drejtohet nga Kryetari i Akademisë.

Neni 13

Kryetari

1. Detyrat e kryetarit janë:
 - a) drejton e organizon punën e veprimtarinë e Akademisë e të Kryesisë;
 - b) përfaqëson Akademinë në marrëdhënie me të tretët dhe nënshkruan në emër të saj;
 - c) raporton në Asamble për aktivitetin e përgjithshëm e në Kryesi për aktivitetin semestral;

- d) drejton mbledhjet e Asamblesë;
- e) nënshkruan vendimet e Kryesisë dhe të Asamblesë;
- f) zbaton detyrat e përcaktuara në Statut.

2. Në zbatimin e detyrave dhe kompetencave të tij, Kryetari nxjerr urdhra e udhëzime. Kryetari ushtron detyrën pas dekretimit të zgjedhjes nga Presidenti i Republikës. Në rast se Presidenti i Republikës nuk shprehet brenda 45 ditëve, dekretimi konsiderohet i kryer në heshtje.

KREU IV

VLEFSHMËRIA, PAPAJTUESHMËRITË DHE NDËRPRERJA E MANDATEVE

Neni 14

Vlefshmëria

1. Me zgjedhjen si anëtar i Asamblesë, personi fiton titullin "akademik", përkatësisht "akademik i asociuar".
2. Titujt "akademik" dhe "akademik i asociuar" janë tituj shkencorë, e si të tillë hiqen vetëm në rastet e ndërprerjes së mandateve të parashikuara në këtë ligj, apo me vendim gjykatë, dhe shoqërohen me një pagesë shtesë të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Kur një anëtar i Asamblesë shkon me banim të përhershëm jashtë vendit, atëherë ai kalon në statusin "anëtar i jashtëm". Në rast rikthimi, rifiton statusin e mëparshëm.

Neni 15

Ndalesat dhe papajtueshmëria

1. Nuk mund të zgjidhen anëtarë të Asamblesë personat mbi 65 vjeç dhe 60 vjeç si akademikë të asociuar.
2. Nuk mund të zgjidhen anëtarë personat që ushtrojnë funksionin e drejtuesit në institucionet kushtetuese a në partitë politike.
3. Nuk mund të zgjidhen anëtarë Kryesie personat që kanë detyra të larta drejtuese, shtetërore ose në partitë politike, sipas përcaktimeve në Statut.
4. Anëtarët e Kryesisë nuk mund të ushtrojnë funksion tjetër me kohë të plotë.

Neni 16

Ndërprerja e mandateve

1. Mandati i anëtarit të Akademisë ndërpritet për një nga shkaqet e mëposhtme:
 - a) Jep dorëheqjen;

b) Për komprometim të rëndë të figurës së akademikut, për shkelje të "Kodit të etikës së kërkimit shkencor" ose për shkaqe të parashikuara në ligj me vendim të Asamblesë, të marrë me shumicë absolute.

c) Për arsye madhore natyrale personale.

2. Mandati i anëtarit të kryesisë ndërpritet për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) Jep dorëheqjen,

b) Plotëson një nga shkaqet për heqjen e mandatit si anëtar,

c) Pranon të zgjidhet ose emërohet në një funksion të papajtueshëm të parashikuar në nenin 15, pikat 3, 4.

d) Mbush moshën 75 vjeç,

e) Shkarkohet nga Asambleja me 2/3 e votave, për shkelje të rënda në ushtrimin e detyrës.

3. Në rastet e germave "a" dhe "d", personi e ushtron detyrën deri në zëvendësim.

4. Në rastet e tjera Kryetari zëvendësohet përkohësisht nga nënkryetari, ndërsa anëtarët e tjerë nga një person i caktuar nga Kryesia.

KREU V

STRUKTURAT E NJËSITË NDIHMËSE

Neni 17

Seksionet

1. Me qëllim organizimin e punës dhe realizimin e funksioneve të saj, anëtarët e Asamblesë ndahen në seksione, sipas grupfushave kryesore.
2. Detyrat, përgjegjësitë, përbërja, mënyrat e drejtimit dhe funksionet e seksioneve përcaktohen në Statutin e Akademisë.
3. Seksionet mblidhen jo më pak se 4 herë në vit.

Neni 18

Komisionet

1. Pranë Akademisë ngrihen komisione të përhershme ose komisione të posaçme.
2. Në përbërje të komisioneve ka si anëtarë, përveç akademikëve, edhe përfaqësues të institucioneve dhe qendrave të kërkimit shkencor dhe të arsimit të lartë.
3. Komisionet ngrihen sipas fushave. Emërtimi, lloji, objekti dhe detyrat e tyre caktohen në Statutin e Akademisë.
4. Komisionet e posaçme ngrihen nga Kryesia sipas përcaktimeve në Statut.

Neni 19

Njësitë e kërkim-studimit

1. Sipas nevojave, detyrave e problemeve në fushën e kërkimit, në përmbushje të rolit të saj, pranë Akademisë mund të ngrihen njësi të kërkim-studimit me aktivitet afatshkurtër e afatgjatë.
2. Këto njësi janë autonome në realizimin e detyrave të tyre, mbajnë marrëdhënie me Kryesinë e Kryetarit dhe raportojnë pranë tyre.
3. Sipas rëndësisë, problemeve e kohëzgjatjes, këto njësi ngrihen me akte të Asamblesë, Kryesisë apo të Kryetarit për njësitë me afat deri në 2 vjet, dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për njësitë e tjera.
4. Objekti i tyre, financimi, shtrirja, veprimtaria dhe përbërja përcaktohen në aktet përkatëse që dalin për ngritjen e tyre.

Neni 20

Akademia e të Rinjve

1. Me qëllim inkurajimin drejtpërsëdrejti të veprimtarisë kërkimore-shkencore të kërkuesve të rinj dhe për vendosjen e një ure komunikimi dhe promovimi me ta, funksionon Akademia e të Rinjve, si organ këshillues e bashkëpunues pranë Akademisë. Akademia e të rinjve ka deri në 20 anëtarë, të zgjedhur nga radhët e kërkuesve të rinj me gradën shkencore "doktor". Mandati si anëtar është 4–7 vjet dhe ndërpritet në moshën 42 vjeç.
2. Në përbërjen e saj synohet përfaqësimi nga të gjitha fushat kryesore të dijes, kulturës e shkencës.
3. Anëtarët e Akademisë së të Rinjve përfshihen në komisionet e Akademisë, marrin pjesë në mbledhjet e seksioneve, si dhe një përfaqësi e tyre prej 3–4 vetash, marrin pjesë në mbledhjen vjetore të Asamblesë, ku miratohet raporti, plani vjetor e projektbuxheti.
4. Akademia e të Rinjve funksionon si një organizëm autonom në bazë të një statuti të miratuar prej saj dhe prej Kryetarit të Akademisë.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

Marrëdhëniet me institucionet shtetërore

1. Akademia ia përcjell raportin vjetor Këshillit të Ministrave e ministrisë përgjegjëse për shkencën dhe Komisionit Parlamentar përkatës.
2. Në mbledhjen e saj vjetore për miratimin e programit marrin pjesë aktive, me ftesë të Kryesisë, përfaqësues të institucioneve kryesore të kërkimit, të ministrisë përgjegjëse për shkencën dhe të Këshillit të Ministrave.

3. Akademia përfaqësohet me të drejta të barabarta në të gjitha organet në nivel kombëtar të parashikuara të ligji për shkencën nga persona të autorizuar prej saj.
4. Një herë në vit organizohet dialogu Akademi – Qeveri, sipas një marrëveshjeje dypalëshe.

Neni 22

Administrata

1. Kryesia e Akademisë, në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe për kryerjen e shërbimeve administrative, profesionale e teknike, mbështetet nga administrata e Akademisë. Nëpunësi më i lartë i administratës është kancelari. Kancelari është autoriteti më i lartë administrativ i Akademisë së Shkencave. Kancelari kryen këto funksione:
 1. Harton projektbuxhetin vjetor mbi bazën e propozimeve të seksioneve dhe mbështetur në strategjinë e zhvillimit të institucionit;
 2. Drejton procedurat e prokurimit të buxhetit dhe është urdhërues i tij;
 3. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit;
 4. I paraqet Asamblesë raportin vjetor mbi veprimtarinë financiare të institucionit;
 5. Detyra të tjera të administratorit përcaktohen në statut dhe në rregulloret e institucionit.
2. Zgjedhja e kancelarit, mënyra e pranimeve në administratë, si dhe mënyra e funksionimit të saj përcaktohen në rregulloren e brendshme të miratuar nga Kryesia, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.
3. Struktura, organika dhe niveli i pagave për administratën përcaktohen nga Asambleja me propozim të Kryesisë, në përputhje me kriteret dhe nivelet e përcaktuara në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar. Pagat për Kryesinë përcaktohen sipas lidhjes nr. 1 të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, ku pagat e Kryetarit, zëvendëskryetarit e anëtarëve të tjerë të Kryesisë njehsohen respektivisht me klasifikimet B, D, E, ndërsa në rast shpërblimi për funksionin, me shtesë page zbatohen kriteret e nenit 5 të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar.

Neni 23

Financimi

1. Akademia është një institucion buxhetor.
2. Veprimtaria e saj financohet nga:
 - a. buxheti i shtetit;
 - b. shërbimet tekniko-shkencore që kryen për persona; juridikë e fizikë jashtë sistemit të saj;
 - c. aplikimet, projektet, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

3. Të ardhurat nga pikat “b” e “c” nuk zvogëlojnë buxhetin e përgjithshëm sipas pikës “a” dhe ato përdoren sipas rregullores së brendshme përkatëse të Akademisë.
4. Projektbuxheti i radhës i dërgohet ministrisë përgjegjëse për shkencën dhe Komisionit Parlamentar përkatës. Në komisionet parlamentare Akademia ftohet ta mbrojë vetë projektbuxhetin e saj.

Neni 24 **Statuti i Akademisë**

1. Rregullat, procedurat dhe kriteret më të hollësishme për ushtrimin e kompetencave dhe për funksionimin e Akademisë e të organeve dhe strukturave të saj, në zbatim të këtij ligji e në plotësim të tij, përcaktohen në Statutin e Akademisë të miratuar sipas nenit 7, pika 6 të këtij ligji, si dhe në rregulloret e brendshme të dala në bazë të këtij Statuti.
2. Statuti i ri i Akademisë dhe aktet e tjera të brendshme do të miratohen brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Deri në miratimin e tij do të zbatohet statuti që është në fuqi, për aq sa dispozitat e tij nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 25 **Dispozita të Fundit**

Akademia e të rinjve e ngritur me vendim nr. 14, datë 7 qershor 2017, i Kryesisë së ASH-së, do të vazhdojë të funksionojë deri në plotësimin e mandatit sipas këtij ligji. Anëtarësimet e reja do të bëhen pas miratimit të Statutit të ri e në bazë të tij.

Neni 26 **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji Nr. 9182, datë 5.2.2004 “Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 27 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi